



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1365 Prot.

Tiranë, më 02.07.2026

**VENDIM QARKULLUES**

Nr. 50 Datë 02.07 2026

**“PËR  
MIRATIMIN E HAPJERS SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT  
MASTER I SHKENCAVE NË "REHABILITIM TË PROFESIONEVE TË  
SHËNDETIT" NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT" DHE  
UNIVERSITETIT "MAGNA GRECIA" TË KATANXAROS NË ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në LAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimin nr.310 datë 11.05.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 7, 43, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 24 të Rregullores së UST-së, në Vendimin Qarkullues të Rektoratit nr. 89 datë 01.07.2026, shkresën e Ministrisë së Arsimit nr.5049 Prot., datë 30.06.2026 "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve", shkresën nr. 76/9 prot., datë 01.07.2026 të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit "Përcjellje për miratim të Rregullores së programit të përbashkët të studimit Master i shkencave në "Rehabilitimi të profesioneve të shëndetit", në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik nr. 98 dt 01.07.2026 , Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 02.07.2026,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit Master i shkencave në "Rehabilitim të profesioneve të shëndetit".
2. Programi i përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze.
3. Kodi i programit të përbashkët të studimit është P72MS09151 (shkresa bashkëlidhur)

4. Efektet financiare që burojnë nga kjo marrëveshje do të miratohen në buxhetin e cdo viti.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

